

KOSOVARJA

Ballina: Njomza Maksutaj

Mos u bëfsh
me lypë ndihmë
prej shtetit

Nuk marrë burrë
pa 100 mijë euro
në bankë

Vetëm budalla
martohet

Ç'thotë e pakënaqura
në martesë

Liza Gjini,
maestro e bukurisë
dhe estetikës

Nazmi Viqa
edhe një mandat
në UB

NJOMZA MAKSUTAJ

*gruaja e boksierit
Azem Maksutaj
kampionë në jetë*

remos

DENTIFIX

SHERWOOD

allüre

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

MOLLA

Shkenda Dëshmor

Banaderm

MARITIM

CIMA



DINO
QERAMIKA

DINO QERAMIKA

Një gamë e strukturuar ngjyrash, efektesh dhe përfundimesh, të aftë për të kënaqur shijet dhe nevojat më të ndryshme estetike përmes kombinimeve të koordinuara ose kontrasteve të përzierjes dhe përputhjes.



Na Vizitoni

Magjistranja Prishtinë
Ferizaj - Konjuh



dino-company.com



+383 49 566 667



Nuk marrë burrë që nuk i ka 100 mijë euro në bankë!

Jam vajzë, 25 vjeçe. Jetoj në Gjilan. Jam në kërkim të fatit të jetës, por ende s'e kam gjetur nafakën time.

Pse?

Se kërkoj shumë nga jeta, apo, siç thonë pleqtë, "Kësmetit s'i dihet se është i fshehtë!"...

Jam në kërkim të fatit të jetës, por ende nuk e kam gjetur kësmetin, sepse nuk thonë kot se kësmeti nganjëherë është i fshehtë.

E kam kryer shkollën e mesme. Fakultetit ia kam pas nis dhe nuk e kam kryer. Nuk jam prej atyre që mendojnë se të vyen shkolla, sepse sot po të kesh bukuri e fat, edhe pa shkollë gjen burrë të mirë, meqë Kosova është mbushur me biznesmenë të pasur, që nuk ia dinë fundin pasurisë.

**GRAMATIKA,
MATEMATIKA
E BIOLOGJIA
SOT NUK TË VYEJNË GJË!**

Sot me rëndësi është të jesh e bukur, me fat dhe të jesh e gjindshme, sepse gramatika, matematika e biologjia më s'të vyejnë gjë. Më askush nuk të pyet a je i dijshtëm a jo...

Sot në formë janë biznesmenët. Andaj, burri që s'i ka 100 mijë euro në bankë

nuk është për mua!

Burri duhet me kanë edhe i bukur, e jo naj farë trullani, ani pse ka para e firmë të veten...

Duhet të jetë edhe i shtirë, që kur ta thotë fjalën të dihet se është fjalë burri, e jo fjalë fëmije...

Burri duhet me punuar, me pasur para në bankë, e jo me i këqyr xhepat sahat e dakik edhe sa para i kanë mbetur...

**BURRI NUK DUHET LËNË
GRUAN TË PUNOJË NË
"HAM TË HYRËS!"**

Burri duhet të punojë shumë, e jo të pret prej gruas të punojë nëpër hamama, siç thotë populli.

Burri i mirë i thotë gruas: Qe para, e ti rri te shpija! Por, kullerat e sodit s'dinë çka është gruaja...

Andaj, çdo ditë e më keq po bëhet për femra, për ato që duan burrë e familje...

D. S.

Në 55 vjet jetë vetëm një ditë e pata gëzim!

U takuam në plazh pas 35 vjetësh. Ajo më thoshte të protestoja pse isha rritur e bërë burrë. Dhe, në fund, u bindëm se kishim jetuar për atë ditë 35 vjet!

Një zonjë e rëndë, shtathedhur, po qëndronte në zallin e Plazhit të Madh të Ulqinit me një libër në dorë. Më dukej se ishte më e preokupuar me fëmijët që laheshin në det, sesa me librin që e mbante në dorë. Unë isha shtrirë në drejtim të ujit të detit dhe vështroja një pulëbardhë, e cila afrohej deri afër meje në kërkim të ushqimit.

Dhe, mu kujtua në çast një ambient i kaluar para sa e sa vitesh, në vitin e parë të shkollës së mesme...

Aso kohe pata botuar vjershën e parë me titull "Miku i zogjve".

E, si një djalë që nuk e kisha ndërruar kurrë frizurën, jetoja me krenarinë për vjershën e botuar.

Aso kohe nënës sime i kishte thënë një e njohur e jona se më donte. E, nëna ime vetëm i kishte buzëqeshur dhe nuk i kishte thënë dot gjë.

Dhe, kur arrita në shtëpi, nëna më tha se filania... i kishte thënë se më donte mua.

"A ke pasur ti guxim t'i thuash babait se e do?", i thashë nënës.

"Jo, s'kam pasur!", ma ktheu ajo.

"Eh, e sheh ti, ajo ka guxim dhe të paska thënë se më do mua!", ia ktheva unë.

Dhe, e di se me kaq u përmbyllë ai kapitull i asaj kohe...

SIMPATINË TIME MA GRABITI PROFESORI NGA ULQINI

Në Ferizaj dikur kishte shumë poetë, madje ekzistonte edhe grupi letrar "Jeronim de Rada", në të cilin edhe tuboheshim ne, të interesuarit.



Ulqini

Aty ndodhej edhe ajo, e cila i kishte thënë nënës sime se më donte mua... Andaj edhe më kishte kapluar vala e syrit të saj, mua, djaloshin që zgjohe-sha me frizurën që ma krijonte natën jastëku ku flija.

Dhe, në gjithë atë përpëlitje mendimesh, mu kujtua tash mu ajo, të cilën ma pat "grabitur" profesori nga Ulqini.

Ajo, aso kohe, mbaj mend, kishte sy si të gjarprit...

E, mu ata sy më bëhej se i shihja edhe tash, teksa rrezitesha në plazh...

E, kur pa se unë veç isha tretur në mendime, mu afrua edhe më afër dhe më tha:

"Hy nën ombrellë se të djegë dielli!".

"Mirë e ke, sepse kur ndizem nuk më fik as deti!", ia ktheva.

"Dukesh i dëshpëruar?!", vazhdoi tutje.

"Jo, as i lumtur e as i dëshpëruar! E,

mesi qenka më i vështiri", ia ktheva. Në moment ra heshtja. Ajo uli kokën dhe më la përshtypjen se me kaq përfundoi edhe ky "teatër". Dhe, në çast mendova se kishte të drejtë. Sepse, kush do të fliste me një budalla si unë, i cili në vend të fjalëve të bukura, shprehte dëshpërimin pse ishte rritur...

E ajo, sygjarpërushja, u afrua shumë pranë meje dhe më tha:

"Ti ende i paske sytë e njëjtë!".

"E, ku m'i njeht ti sytë mua?!", ia ktheva me habi.

"Ti njoh, sepse unë jam ajo... ajo që më pat "rrëmbyer" profa i Ulqinit..."; më tha me një buzëqeshje të lehtë.

"Ti... ajo?! Ti?!"; belbëzova në vete.

"Po, po, vetë unë! Dhe, 35 vjet e kam pritur këtë ditë, këtë takim..."; më tha duke ma shtrënguar dorën fort.

S. M.

Te baba princeshë, te burri baj dru!

Si vajzë kam pasur jetë të mirë dhe kam qenë më e ledhatuara në familje. Madje, më konsideronin si princeshë. Tërë ditën i kushtoja rëndësi pamjes sime, kryesisht fytyrës dhe thonjve. Por, prej se jam martuar qohem në 6 të mëngjesit dhe u rrekem punëve të shtëpisë, madje qaj edhe dru!

Të gjitha vajzat e reja, para se të mar-tohen, mundohen të gjejnë djalë që është i pasur, kurse me mua ndodhi e kundërta: më mirë i kam pasur kush-tet te baba 100 herë se te burri! Sepse, për mua gjithmonë ka qenë më me rëndësi që burri të jetë i varfër e njeri, sesa me kushte të mira e dal-laveraxhi.

BURRI I MIRË TË DO E NUK TË SHANË

Andaj, prej se jam martuar gjithmonë i them burrit se kurrë nuk më ka intere-suar pasuria, por rehatia në familje. I them të ketë respekt ndaj meje, të më duaj e jo të më maltretoj e shaj, siç bëjnë shumë burra që i njoh unë.

Por, edhe në skamje e varfëri qenka vështirë, sepse te baba si princeshë jam rritë me të gjitha të mirat, e te burri po shkurtoj dru!

Por, më e keqja është se, edhe pse jam martuar qe pesë vjet, ende nuk kam fëmijë. E, kjo po më mundon shumë. E kam biseduar me burrë këtë gjë, por ai bëhet sikur nuk i intereson. Më thotë ka kohë, madje as te mjeku nuk më qon për kontroll, që të zbulohet mos kam ndonjë problem shëndetë-sor.

BURRI AS TE MJEKU NUK MË QON!

Dhe, duke parë se atij nuk i intereson një gjë e tillë, më kanë dërguar te

mjeku familja ime.

E, kur i tregova se isha te mjeku, desh u qartë duke më bërtitur pse kam shkuar...

Në anën tjetër, familjes së tij u in-teresoja shumë, sepse e dinë se unë kam pasuri në familje dhe nuk i lë të heqin për asgjë.

Dhe, kur një ditë u tregova në familje se po heq shumë në atë familje, në vend se ata të më përkrahnin, më qortuan duke më thënë se vetë e kam zgjedhur dhe vetë ia pafsha hajrin... Sidoqoftë, nuk thonë kotë "O kuku çka i bëra vetit!"

Pra, edhe unë, me sy në ballë, e lypa dhe e gjeta vetë...

Mihrija, Shtime



Mos u bëfsh me lypë ndihmë prej shtetit!

Edhe pse kanë kaluar mbi njëzet vjet e tfu, “e shihja” vitin 1999 në çajtoren ku pinim çaj. Njerëzit përllaheshin në çajtore ndërmjet veti, duke sharë pse nuk po realizohen kërkesat e arsimtarëve...

E, dallimi për 20 vjet e tfu me vitin 1999 është se atëherë e donim luftën për ta fituar shtetin, ndërsa tani e kemi shtetin, por politikanët punojnë kundër popullit!

Në kafene bëhet politika, bëhet zhurma debatuese për gjendjen e mjerë ekonomike dhe për shumëçka tjetër që e lidhë shtetin me dështimin.

Hyra në çajtoren e fshatit tim një pasdite, sepse zhurma e bisedës apo e përlarjes ishte e madhe dhe krijova bindjen se do rrahën ndërmjet veti.

Mu kujtua viti 1999, kur vija nga Prishtina në shtëpi, pak para bombardimeve të NATO-s në Kosovë. Ndaloja në shitoren e parë, e që ishte e mbushur me qytetarë që prisnin lajme, sepse gjërat e këqija vinin tepër shpejt...

Për dallim nga viti 1999, kur flisnim se kur të kalojë lufta ata që do mbetën do të jetonin në shtetin e tyre me emrin Kosovë, tash njerëzit flasin kundër shtetit të veti! “Ky shtet është i hajnave! Askush prej politikanëve nuk është për shtet, por krejt janë për hajni!

Pse po e kërkojmë hasmin në Serbi, kur e kemi këtu?! Me Serbinë i kemi kryer punët më 1999, e na kanë mbetur vetëm edhe do punë që tejkalohen me marrëveshje,

por hasmin e kemi këtu, në mesin tonë!, flet një burrë i mbushur vrer e inat.

“Ndal pak, he burrë, se nuk e kemi hasëm shtetin tonë, se shteti po na përkrah, po na mban, po kujdeset për ne”, i them unë zotërisë.

Por, ai ma ktheu shpejt e shpejt: “Hasmin e kemi këtu, thashë, dhe nuk i ndërroj fjalët kurrë! Po na vjedhin, na sosën duke na i marrë krejt çka kemi! Shihni me rrymë si është puna - ta këpusin rrymën pa fije turpi, edhe po të kesh fëmijë të vegjël, edhe nëse ke dikë duke vdekur në shtëpi!”, ma kthen ai.

**SHTETIT
NUK I INTERESON
PSE NXËNËSIT NUK
SHKOJNË NË SHKOLLË
QE RRAFSH NJË MUAJ!**

Dhe, muhabeti në çajtore nuk ndalej... Njerëzit kanë shumë halle, ka familje që nuk kanë as bukë në sofër! Shtetit nuk i

intereson i varfëri. Shtetit nuk i intereson pse nxënësit nuk shkojnë në shkollë rrafsh një muaj!

E takova një aktivist të “Vetëvendosjes”, e që e njoh mirë. E pyeta: “A po vyeni diçka a jo?”

“Po, qysh nuk jemi duke vyer, bre?! Çdo punë po ecë flakë!”

Kjo ma kujtoi një batutë të një miku, që tregoi për një vjehërr që i kishte pasur dy reja. E pyet një zonjë vjehërr:

“Si po kalon me rejat?”

“Shumë mirë”, ia kthen ajo.

“A më mirë po kalon me të madhen a me të voglën?”

“Më mirë me të voglën, për besë, se kur flas, reja e madhe më thotë: “A nise me fol, a?!”

E, e vogla më thotë: “Mos fol shumë!”. Edhe ne, pra, jemi në një shtet ku gjërat janë të njëjta, qeveri pas qeverie... Premtime sa të duash e punë fare! Secila parti premtion e premtion e kur vjen në pushtet nuk bën asgjë!

EDHE DURIMI KA FUND!

Vrasja e kohës është vetëm një emër për mënyrën tjetër se si koha na vret neve...



Nuk duket racionale përherë ta fajësojmë historinë, ta fajësojmë Evropën, botën për padrejtësitë ndaj kombit dhe popullit tonë. Këto fajësime nuk janë kontestuese.

Por, po qe se vazhdojmë të merremi me vetveten, do të pranojmë logjikën vetërrënuese. Gjendja në të cilën jemi nuk mund të përballohet as lehtë e as shpejt pa bashkimin e forcave. Dhe, po qe se këtë nuk e bëjmë, do të ballafaqohemi me plasaritje dhe ndarje të reja.

E, plasaritjet dhe ndarjet popullore dhe kombi shqiptar i ka paguar shumë shtrenjtë në të kaluarën.

Kërcënohet rreziku që këto të tashmet t'i paguajmë edhe më shtrenjtë...

*

Me politikë duam të merremi të gjithë, edhe pse marrja me politikë kërkon prirje të veçantë. Politika nuk është zeje që mësohet, por shkathësi që lind e zhvillohet.

*

Partitë tona gabimet e partive të tjera i qesin para dhe i shohin, ndërsa gabimet e veta i qesin prapa dhe nuk i shohin!

Partitë, të cilat për veten mendojnë se janë të pagabuara, gabojnë qysh në start.

Koha po ecë...

Po ashtu, edhe mospajtimet po vazhdojnë dhe veç çka po ashpërsohen edhe më shumë.

E, populli po sheh, po duron... Por, edhe durimi e ka një fund!

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Njomza Maksutaj-Tolaj është modeli i femrës ideale në të gjitha dimensionet. Profesioniste e jashtëzakonshme në fushën e financave, bashkëshorte e nënë e dedikuar dhe grua me stil e elegancë të lakmueshme.

E rritur në Zvicër, e integruar në mënyrën më të mirë të mundshme, Njomza Maksutaj-Tolaj paraqet shembullin e gruas shqiptare në Diasporë me status dhe pozicionim tejet të mirë në sferën shoqërore e profesionale.

Dhe, sado që është përpjekur të rrijë larg syrit të publikut dhe medieve, ajo e ka pasur thujtë të pamundur të qëndrojë gjithmonë në hije, shkaku se është bashkëshortja e njërit prej sportistëve më të trofeshëm shqiptar në botë, boksierit Azem Maksutaj, i njohur edhe si “Shqiponja e zezë”.

Azem Maksutaj mbanë mbi supet e tij hiç më pak se katërmëdhjetë trofe bote në kimboksin dhe taiboksin profesional. Imazhi i këtij numri të “Kosovares” flet për veten, bashkëshortin e saj të suksesshëm e të famshëm dhe për shumë të pathëna...

Njomza Maksutaj, gruaja e boksierit Azem Maksutaj, kampione në jetë



Na fol pak për veten, për Njomza Maksutajn që duhet ta njohim, vërtet?

- Jam bashkëshorte, nënë e dy djemve të mrekullueshëm dhe grua e angazhuar profesionalisht. Jam në bordin ekzekutiv të dy kompanive, gjegjësisht bankave private. Jam grua e përkushtuar ndaj familjes, ambicioze në përgjithësi dhe e dua jetën. Më pëlqejnë kulturat dhe historitë e ndryshme dhe pasioni im i madh është ta kërkoj e eksploroj botën.

Jam femër e emancipuar që impresionohem nga historitë e femrave që arrijnë diçka në jetë, e të cilat i përkrah plotësisht.

Aty ku kam ndikim mendohem të ndryshoj për të mirë, kam dëshirë të ndihmoj aty ku ka nevojë.

Je nga një familje intelektualësh, që, pa dyshim, ka ndikuar në formimin tuaj individual. Si e komentoni këtë?

- Për prindërit e mi ka qenë gjithmonë primare shkollimi dhe dituria, por duke e ruajtur mentalitetin, kulturën dhe traditën shqiptare.

Jam rritur larg vendlindjes, por prindërit janë kujdesur që gjithmonë të na këshillojnë dhe edukojnë sipas kulturës shqiptare. Babai, prej viteve 80 e deri pas lufte, ka qenë me angazhime të ndryshme politike. Si fëmijë, disi, kemi qenë të "detyruar" të merreshim me tema të ndryshme rreth Kosovës, të angazhoheshim rreth vendit tonë, të bëheshim pjesë e angazhimeve të ndryshme të Diasporës për të ndihmuar vendlindjen, të bëheshim pjesë e demonstratave etj.

Çdo të mërkurë, pasdite, kam shkuar në shkollën shqipe në Zvicër tetë vjet rresht, e që sot jam shumë e lumtur, sepse kam mësuar ta shkruaj gjuhën tonë dhe, gjithashtu, kam mësuar për



historinë tonë shqiptare.

Jemi popull i vogël, andaj është e rëndësishme të kujdesemi që të mos asimilohemi.

Pra, prindërit duket se të kanë frymëzuar shumë, a?

- Duke u nisur nga rëndësia e shkollimit, më kanë motivuar e mësuar të mos dorëzohem dhe të luftoj për të drejtat e mija, të jem e emancipuar dhe e pavarur.

Kemi mësuar nga prindërit se duhet trajtuar të tjerët siç kishim dashur të na trajtojnë ata neve.

Prindërit na kanë mësuar dhe frymëzuar për ta dashur vendin tonë, për të qenë krenarë me rrënjët tona.

Sot, si e kujton fëmijërinë, adoleshencën dhe rininë e hershme?

- Jam, vërtet, e bekuar, sepse kam pasur një fëmijëri shumë të mirë. Jam rritur me gjyshe dhe me gjysh (nga ana mamit), meqë prindërit e mi kanë qenë të dy të punësuar derisa jemi detyruar ta lëshojmë Kosovën për shkak të situatës së vështirë politike në vend.

Është bekim të rritesh me gjyshër, siç i kam pasur unë. Më kanë mësuar shumë gjera dhe kemi jetuar në një harmoni të paharrueshme.

Megjithëse kam qenë e vogël, ende kam shumë kujtime të bukura nga

fëmijëria e hershme. E kam pasur një lidhje të jashtëzakonshme me gjyshen time, e cila për fat të keq ka ndërruar jetë para tre vjetësh. Dhe, me vdekjen e saj pothuajse është varrosur një pjesë e fëmijërisë sime.

Sa ishte sfiduese të integroheshit në një vend si Zvicra?

- Fillimi nuk ishte i lehtë, sidomos në aspektin e integritimit, pasi ishte një kulturë e re për ne, duhej ta mësonim gjuhën, të krijonim shoqëri të re etj.

Besoje se në atë kohë ka qenë e vështirë edhe për prindërit, njëjtë si për ne fëmijët.

Si shumica e prindërve në atë kohë, edhe të tanët kanë jetuar me shpresën për t'u rikthyer një ditë në Kosovë.

Por, me shpërthimin e luftës në Kosovë nisën të shuheshin shpresat për rikthim. Gjithsesi, mendoj se gjeneratat më të vjetra besoj se e kanë pasur shumë më të vështirë integrimin.

Sot, për mua, Zvicra është vendlindja e dytë, pasi këtu e kam krijuar jetën time. Është krejt normale që një pjesë e zemrës sime është përherë në Kosovë. Them se të rritesh në dy kultura të ndryshme është barrë dhe bekim, njëkohësisht, siç quhet edhe libri i shkrimtares Shqipe Sylejmani.

Ndërkohë, në rininë tuaj e njohët Azem Maksutajn, emër i artë i sportit. Si ndodhi?

- Azemin e kam njoftuar qëkur isha 18 vjeçe. Jemi njoftuar në sport, jemi dashuruar dhe, pastaj, kemi bashkëjetuar.

Më duhet të pranoj se bota e sportit luftarak ishte diçka e re për mua...





Thonë se pas një burri të suksesshëm gjithmonë qëndron një grua e zonja dhe ky është pikërisht rasti juaj apo jo?

- Kur e ke një burrë të suksesshëm, duhet të jesh edhe ti e zonja që t'i dalësh në çdo sfidë. Unë kam qenë dhe jam adhuruesja më e madhe e Azemit, sepse e kam parë dhe e di se çfarë domethënie ka ky sport për të. Për mua sporti ishte thjesht sport, e për të ishte vetë jeta. Shpesh ka qenë e vështirë ta mbështesë në meçe të ashpra luf-tarake, sidomos duke e ditur se nuk e pranon asnjëherë dorëzimin. Gjith-monë kam shkuar me frikë t'i përcjellë meçet e tij. Azemi e ka pasur një karrierë të gjatë e të bujshme. Andaj, për sportistin është tejet e vështirë që të vendosë ta përfundojë karrierën dhe njëjtë ka ndodhur edhe me bashkëshortin tim. Pasi u dha premiera e filmit të tij në kinema, ia bëra me dije se ishte koha ta përfundonte karrierën dhe ky ishte një mision i vështirë për mua dhe për

të. Gjithsesi, pasi është bërë baba, e ka kuptuar edhe vetë se motivimi dhe vullneti më nuk ishte i njëjtë.

Po, si është të jesh bashkëshortja e Azem Maksutaj?

- Nuk besoj se marrëdhënia jonë ndryshon shumë nga marrëdhëniet e të tjerëve. Normalisht, më është dashur të mësohem me afeksionin e njerëzve ndaj Azemit, pasi ka shumë persona që e adhurojnë. Gjithsesi, jam shumë krenare, ani pse më është dashur kohë për ta akceptuar sjelljen e njerëzve kur e shohin Azemin, i cili me arritjet e tij në fushën e sportit, sigurisht, e ka

merituar simpatinë dhe respektin që gëzon.

Të jetosh me një kampion është sfidë, privilegj, apo?

- Janë të gjitha bashkë. Azemi më jep gjithçka nga vetja dhe unë krenohem me atë se çfarë bën për ne: mua dhe dy djemtë tanë. Është baba tejet i dedikuar. Jam krenare me fitoret e tij dhe me faktin se sa të lumtur i ka bërë shqip-tarët në kohët më të vështira.

Sa është mirëkuptues Azemi si bashkëshort, a të ndihmon?

- Është mirëkuptues dhe mbështetës, por ka mjaft dëshirë të bëjë surpriza. Më jep fuqi dhe kurajë t'i dal çdo gjëje, duke u përpjekur kështu të më bëjë gruan më të lumtur në botë. E mira është se i kemi të njëjtat mendime rreth edukimit të fëmijëve tanë. Unë përkujdesem më shumë në aspektin e shkollimit të tyre, ndërkaq Azemi për hobet që kanë. E përkrahim njëri-tjetrin dhe rrallë vendosim për ndonjë gjë pa u konsul-tuar bashkë.

Pak më shumë për djemtë tuaj?

- I kemi dy djem, Leandro Leon, 15 vjeç dhe Klevisin, 9 vjeç. Leandro është në shkollën ekonomike dhe luan për U16 FC Winterthur Football. Klevisi është në shkollë fillore edhe, gjithashtu, merret me futboll dhe vrapim. Koha që e kalojmë me fëmijët është ndër gjërat më cilësore për ne. Unë dhe bashkëshorti im shumë shpesh i përcjellim djemtë në aktivitetet e tyre sportive, madje edhe në trajnime.

Njomzë, për ata që nuk e dinë, a mund të na thuash ku është i orientuar angazhimi juaj momentalisht?



- Momentalisht jam në bordin ekzekutiv të tri firmave në Zvicër dhe në Gjermani, ku udhëheq rreth 40 punëtorë. Përkujdesëm për menaxhimin e pasurisë së sportistëve të ndryshëm, si dhe të njerëzve të pasur (private banking & real estate). Gjithashtu, i ndihmoj bashkëshortin tim në menaxhimin e shkollave sportive që ai i udhëheqë. Mundohem që, pavarësisht angazhimit intensiv profesional, të gjejë kohë edhe për familjen. Kohën e lirë ua përkushtoj fëmijëve tanë.

Jeni model i gruas shqiptare në Diasporë me status dhe pozicionim tejet të mirë në sferën shoqërore e profesionale. Si ia del në krye?

- Nuk ishte dhe nuk është aq e lehtë. Në jetë gjithmonë duhet të mësosh të bësh kompromise. Duhet t'ia bësh vetes me dije se nuk mund t'i kesh të gjitha përnjëherë. Nëse orientohesh shumë rreth punës e pasurimit, duhet ta dish se nuk do të kesh kohë për veten e familjen. Kur të krijosh familje, duhet ditur se disa gjëra, dalja e hobi, mund të mohohen në një masë. Personalisht, përherë kam provuar ta krijojë një balancë të shëndoshë në jetë. Them se më ka ndihmuar edhe reflektimi pozitiv, me të cilin edhe i edukoj fëmijët, por edhe mbështetja pa kusht e bashkëshortit, pasi gjatë mungesës sime ai kujdeset për fëmijët dhe familjen. Gjatë karrierës aktive të tij i kam ndihmuar unë, e tani më ndihmon ai mua...

Sa sfiduese ka qenë rruga drejt suksesit?

- Si e huaj në një vend, je e detyruar të bësh dyfishin e angazhimit për të arritur të njëjtin sukses me një vendas. Sido mos, si femër është akoma më e vështirë të integrohesh në një lami siç është e financave, e cila mbizotërohet nga gjinia mashkullore.

Megjithatë, shumë rrallë jeni ekspozuar në medie. Pse?

- Nuk jam tip i njeriut që e kërkon ose e pëlqen ekspozimin e tepërt. Ndoshta e kam edhe pak prej prindërve të mi që gjithmonë kanë qenë modest dhe na e kanë kultivuar këtë ndjenjë. Normalisht, si partnere, e më vonë bashkëshorte e një sportisti të njohur, je automatikisht e detyruar të marrësh pjesë në projekte mediale të ndryshme, siç ka qenë filmi dokumentar në kinema "Being Azem" ("Të jesh Azemi").

Ka qenë e domosdoshme të jem pjesë e filmit dokumentar. Ekipi i xhirimeve na ka përcjellë pesë vjet me radhë në çdo pushim, në jetën private, duke nisur nga martesja, lindja e djalit të parë, e në shumë situata të tjera.

E, këtë e kam bërë për bashkëshortin tim, pasi që, me të vërtetë, karriera e tij e ka merituar të ekspozohet në kinema. Sidoqoftë, janë shumë pak njerëz që kanë film për jetën e tyre. Pra, kjo është arsyeja që kam pranuar të jem pjesë e filmit, të bëhet diçka reale dhe jo e inskenuar. Pas përfundimit të filmit e kemi ndërtuar një shtëpi për veti. Kemi pasur mjaft kërkesa nga mediet për storie brenda shtëpisë, por nuk kam pranuar që asnjë kamerë të hyjë brenda, kjo ka mundur të ndodhë vetëm jashtë ose në tarracë. Pjesa e shtëpisë tonë tashmë është plotësisht private. Shumë herë edhe në "Instagram" më pyesin pse nuk e tregoj shtëpinë nga brenda. Thjesht, nuk pranoj. Sepse, qëllimi im s'ka qenë kurrë të ekspozohem...

Ndërkohë, dukeni bukur. Është meritë e gjeneve, apo keni regjim a sekret të veçantë?

- Jam e bekuar gjenetikiisht. Qeshi shumë, jam njeri pozitiv dhe kjo i bën njerëzit të duken bukur. Mendoj se bukuria është diçka relative, nuk u pëlqen të gjithëve i njëjti person, i njëjti ideal. Është e trishtueshme kur e shoh se në çfarë ideali ka arritur sot të jetë dukshmëria e një femre. Shumica e femrave duken tejet të njëjta. Tepër artificiale. Unë besoj se bukuria e brendshme, të qenit e kënaqur dhe e dashur me vetveten dhe vetëbesimi, janë ato që të bëjnë të shkëlqesh edhe nga jashtë.

Po e mbyllim bisedën me blogun tuaj në "Instagram"?

- Të vishem bukur dhe të bëj eksperimente me modën, ka qenë pasioni im qyshkur kam qenë e vogël. Blogun e kam hobi, më pëlqen nëse mund ta inspiroj dikë me mënyrën se si vishem, me atë që bëj etj. I kam disa kooperative me kompani të vogla, meqë mundohem t'u ndihmoj bizneseve të vogla. Gjithsesi, ta mbash një blog në mënyrë profesionale të nevojitet shumë kohë. E, momentalisht nuk kam shumë kohë të merrem me këtë, por të ardhmes nuk i dihet asnjëherë.

Nderim Neziri



UNIONI I BIZNESEVE RIZGJEDH KRYETARIN DHE KRYESINË E SAJ



Në Bad Homburg të Gjermanisë, Unioni i Bizneseve shqiptare dhe gjermane në Gjermani ka mbajtur Kuvendin e jashtëzakonshëm, ku është zgjedhur kryesia e këtij Unioni.

Ndërmarrësi i suksesshëm në Gjermani, Nazmi Viqa është zgjedhur edhe për një mandat Kryetar i Unionit të Bizneseve.

Në Kryesi të Unionit janë zgjedhur po ashtu ndërmarrës dhe afarist të suksesshëm në Gjermani. Gani Nuha, është zgjedhur nënkryetar i parë, nënkryetar i dytë Zenun Krasniqi, sekretar i përgjithshëm është zgjedhur Nexhmedin Veliqi, ndërsa anëtar të tjerë të kryesisë janë zgjedhur Bekim

Borovci, Vllaznim Kelmendi dhe Bekim Bytyqi.

Në fjalimin e tij përshëndetës, anëtar i nderit Lazim Destani deklaroi se Unioni duhet t'i bashkoj ndërmarrësit shqiptarë me qëllim që zëri i tyre të dëgjohet kudo në Gjermani dhe bashkërisht t'i tejkalojmë kufinj të gjetjen e mundësive të reja për bizneset shqiptare.

Nazmi Viqa potencoi se qëllimet kryesore të këtij Unioni në katër vitet e ardhshme do të jenë forcimi dhe rritja e urave të bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve në Gjermani, përfaqësimi i bizneseve para institucioneve gjermane, përkrahja e kompanive shqiptare në vendlindje për qasje më të lehtë në tregun gjerman, dhe krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit, investimit dhe shkëmbimit të përvojave.

Kurse në fjalimin e tij, z. Viqa deklaroi se "Unioni buron nga bizneset dhe i tyre do të jetë gjithmonë. Për këtë qëllim së

shpejti në Gjermani do të themelohen gjashtë degë regjionale në: Hamburg, Berlin, Dyseldorf, Frankfurt, Shtutgart dhe Mynih. Ndërkaq në vendlindjet tona do të themelohen zyrat ndërlidhëse në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup"

Drejtori Ekzekutiv i Unionit Fadil Abdulahu prezantoi strategjinë dyvjeçare të Unionit. Ai deklaroi se "Unioni do të jetë platformë dhe zë i fuqishëm i prezantimit të bizneseve shqiptare në Gjermani dhe vendlindjet e tyre shqiptare. Zyrat ndërlidhëse do të luajnë një rol kyç në rritjen e bizneseve shqiptare dhe krijimin e sinergjive të reja me qëllim të rritjes së mundësive investive, qasjes së tyre më të lehtë në treg dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve shqiptare në Gjermani dhe vendlindjet shqiptare".

Unioni i Bizneseve në Gjermani është shoqata më e madhe ekonomike e bizneseve shqiptare në Gjermani.



MARITIM
RESORT MARINA BAY



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

Sa më inatçi, aq më i votuar!

Nuk di kush e ka shpikur inatin, por e di se shqiptarët janë ithtarët më të mëdhenj shpirtëror të tij. E bartin shumë shallin dhe inatin. Shallin në fyt, inatin në zemër!

Teksa me shokë pijë kafënë e mëngjesit, vjen turravrap një njeri dhe ulet në tavolinën afër nesh.

“E kishe bërë një lokal të mirë afër Shkollës “Elena Gjika”. Kur do ta hapësh?”, i thotë tjetrit që ishte aty.

“Së shpejti”, ia kthen ai.

“Për inati të Sylës hape sa më shpejt! Le t’i kupë zemra se nuk ka më të keq e më të ligë se ai!”, i thotë ai.

Dhe, si me tallje kyçem në muhabet dhe e përkrahu inatçiun, duke i thënë se nuk ka më të ligë se Sylë.

“A po e njihje Sylën, a?!”, më thotë.

“Po, ore, kush nuk e njehë Sylën?!”, i them.

“Mirë që edhe ti po mendon si unë, sepse kur po flas për të nuk po më besojnë!”, ma ktheu.

“Të flasësh për Sylën është zero, krahasuar me inatet e të tjerëve, për të cilat njerëzit shkrepin armën dhe shkaktojnë bela të reja. A di sa belaja është bërë pas luftë? Aq sa duhet të fillojë një kapitull i ri i pajtimit. Në Angli është adet që ai që ia ka inati tjetrit të kërkojë “luftë” fer. Dalin në park,

grushtohen dhe pajtohen.

I ke parë kaubojt në filmat vestern: rrahën sa kanë fuqi dhe kur mbesin ratë bëjnë muhabet”, ia kthej unë.

VIJAT E KUQE - DEMEK E KALOVE KUFIRIN!

E keni parë kryeparlamentarin si ua shkyç zërin deputetëve të PDK-së dhe AAK-së? Nëse diçka nuk i pëlqen atij, nuk ka për ta zgatur deputeti fjalën në foltore. Menjëherë pulla e kuqe - kërki! Dhe, secili flet për vijat e kuqe, por askush nuk e di kufirin...

E, edhe graria janë mbushur inate. E keni parë se si reagon me eufori Mimoza Kusari kur ndonjë deputet i LDK-së, PDK-së a i AAK-së flet keq për “Vetëvendosjen”?

JEMI NJERËZ PA DURIM!

Lexova se një basketbollist kosovar ishte suspenduar me gjashtë muaj largim nga parketi. Ky lloj suspendimi i tij më zgjoi kureshtje të madhe, sa u ndala ta shikoj sportin në televizor dhe pashë se si po

ai lojtar i suspenduar i kishte bërë turr publikut me karrige nëpër kokë e kudo që e kishte më kollaj ta përplaste.

Jemi njerëz pa durim, them me vete. Mjaft na ka folur Ibrahim Rugova për durimin, por nuk jemi mbushur mend.

E, shkoi Ibrahim Rugova pa e mbjellë durimin në tokën e Kosovës.

HALLA IME NË GJITHË KOSOVËN KA KUSHËRI...

Jemi shtet i vogël. Të gjithë jemi dajë e nipër, teze e mbesa. Më kujtohet halla ime, ndjesë pastë. Kur futej në muhabet me dikë, kushdo që ishte ai dhe ngado që ishte, ajo dilte e njohshme me të. Edhe nëse ishte nga Peja, e gjente lidhjen! Me një rast, një grua i tha:

“Me të dëgjuar ty, hallë, askush nuk ka për t’u martuar kurrë!”.

“Pse, lokes?!”, i thotë halla.

“Ti, qysh i gjen se bapet, të gjithë janë ilake dhe nuk mund të martohen ndërmjet veti!”, ia kthen ajo.

S. Murturi

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni ne info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

info@remos-restaurants.de

www.remios-restaurants.de



Vetëm sytë e qeveritarëve shohin mirë!

Njeriu edhe hajnit i thotë faleminderit! T'i vjedhë paratë dhe ia bën hallall nëse t'i kthen dokumentet...

Filmat orientalë po shikohen në Kosovë me të madhe dhe televizionet e kanë gjetur veten në këtë "mision" shikueshmërie. Po të mos ishin filmat e tillë, televizionet tona nuk do të shikoheshin në masën sa shikohen tash. Gruaja ime i shikon serialet turke dhe një ditë, teksa po e shikonte njërin prej tyre, në kohën kur luhej një ndeshje ndërkombëtare futbolli, i bëmë dy televizorë në sallonin e shtëpisë. "Ndërroje kanalin grua e qitma futbollin!", i thashë.

"Lëre që je bërë dembel, por edhe nuk po sheh se jam kah e shikoj lften", ma ktheu ashpër.

"Ç'lidhje ka kjo?", e pyeta unë.

"Është një ngjarje për dashuri dhe normalisht që ka shumë lidhje. E, çka ka lidhje

futbolli yt, ku çdo ditë shikon futboll?! Të është mbushur koka vetëm futboll!"

"Mirë e ke, sepse më për dashuri nuk flet askush, pos në serialet tua.

PSE KRYEMINISTRI NUK FLET PËR DASHURI, POR VETËM PËR SUKSESE?

Madje, edhe kryeministri është çoroditur dhe po flet vetëm për suksese, thuajse e ka bërë nami... Mirë do të ishte ta ndërronte temën edhe kryeministri, sepse vetëm po lavdërohet, e kjo i është bërë përditshmëri...

E, kur ai po vetëlavdërohet, disa deputetë të tij i shtrembërojnë buzët në stilin alla katunarçe.

Sepse, në katund, kur dikujt s'i pëlqente diçka kur flisnin, ata që ishin përreth i shtrembëronin buzët. Nuk e kundërshtonin me fjalë, por me buzë tregonin se ai që fliste tregonte përralla...

Tani e kam bindjen se sa më shumë që po lavdërohet kryeministri, aq më shumë kundërshtarë partiakë po bën. Sa më shumë po lavdërohet, aq më shumë po kuptohet se ai po bie nga respekti.

Sepse, kur një burrë lavdëron veten, i bie sikur ezani i imamet të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, të cilin më mirë është të mos e dëgjosh fare kur e thirr ezanin, sepse e thërret aq keq sa nuk të qon mall hoxhe.

A thua, a janë budallenj imamët e tjerë që e lëshojnë ezanin nga CD-ja? Nuk janë

budallenj, por kur e dëgjon ezanin e tyre, reflekton simpati e jashtëzakonshme për fenë”, i thashë gruas, e cila në ato çaste as që kishte qenë duke më dëgjuar.

SIPAS QEVERTARËVE KOSOVA ËSHTË BËRË XHENET!

Nejse, e nisëm me diçka tjetër dhe dola dikur tjetër... Prandaj, të kthehem përsëri te gruaja. Ajo filmin - unë futbollin! E mora televizorin nga dhoma tjetër dhe e vendosa pranë televizorit tjetër. Dy televizorë në një dhomë, madje mbi të njëjtën tavolinë... Unë futbollin ajo lfteten.

“Uh, po kollaj paska qenë ta zgjidhim problemin! Për pak s’u zumë, e zënka kushedi çfarë do të kishte pasuar: shi, breshër a borë”, i thashë.

“Edhe unë do ta kisha dëgjuar kryeministrin po të fliste edhe për dashuri dhe jo vetëm për sukseset e tij, thuajse Kosova është bërë xhenet!”, më thotë ajo me zë të lartë.

“Po, ama, si të flet për dashuri i pari i qeverisë, grua?!”, i them unë.

“Epo, nëse do ta dëgjojë dikush le të flasë për aso teme, se për lavdet e tij më askush s’po e dëgjon!”, më thotë ajo.

“Po flet kështu për kryeministrin grua?!

Ti vetë ia ke dhënë votën! E, tash çka po ndodh me ty?”, ia ktheva unë.

“Asgjë nuk po ndodh, por qeveria nuk po e realizon asnjë premtim që ka premtuar në fushatën zgjedhore.

Shih se çka po ndodh me arsimin, me administratën publike e të tjera?! 350 mijë nënës rrinë në shtëpi e kryeministri ia therr në Japoni!

Nuk ka ngritje pagash, e, në anën tjetër, çmimet në qiell! Pagat askund e shpenzimet si në Evropë! E, besa më nuk do ta votoj, sepse prej tij s’ka hajr”.

“Dikujt duhet t’ia japësh grua!”, ia ndërpres fjalën unë.

“Po, dikujt po, por atij jo!”.

“Eh, mirë që i ke ra pishman se kur të thoshte shoqja jote jepja Hotit, ti thoshe jo se Kurti më bukurosh... Ja pafsh jarin, pra!”.

HAJNI: PO VJEDHIN POLITIKANËT E LËRE MË UNË!

E enjtja që e lamë pas ishte një ditë si zakonisht.

“Ditë e re, fat i ri, thotë mileti, a po jo grua?”, i thashë sapo u zgjuam kur ajo po i bënte kafetë e mëngjesit.

“Po, ashtu thonë, vetëm se një fjalë duhet ndërruar... Fjalën mileti e bëjmë populli”, më thotë ajo.

“Eh, mendova se më lehtë e kupton ti, meqë po i shikon filmat turk, por ke të

drejtë. Edhe Fan Nolin e kishin pas kritikuar për përdorim të tepruar të fjalëve të huaja në poezi, sepse po të kishin shkruar të gjithë si ai do ta kishin vënë në rrezik gjuhën shqipe”.

“A ja nise me filozofua, a?!”, ma ktheu me ironi.

“E lëmë me kaq: “Dita e re, fati i ri”. Ama, nuk i dihet jetës. Në vend të fatit shumë herë vjen diçka tjetër, sikur në poezinë e poetit arbëresh Vorea Ujko, ku vajzës që priste vdekjen i kishte shkrepur fati i mrekullueshëm”.

“Ti me poezi e nis ditën, si Kryeministri ynë me lavde për Qeverinë!”, prapë me ironi ma kthen ajo.

Nejse, ajo shkon në punë me veturë, kurse unë në punë me veturën time. Pas orës 12 më bën zile dhe më thotë se ia kanë thyer veturën. Ia kanë marrë çantën me çdo gjë që ka pasur në të: paratë, dokumentet personale, ato të veturës... Plus xhami i thyer i veturës...

Eh, thashë me vete, ajo që unë i thashë është pjesë e jetës...

Dhe, një ditë, teksa ecja nëpër qytet, pash një djalos që sillej rreth një veture paksa me dyshim. Kur i thashë se a po e shikon atë veturë që të vjedhë gjë në të, ma ktheu:

“Po vjedhin politikanët e lëre më unë! Pse unë të mos vjedh kur askush nuk më sheh, e ata që vjedhin çdo ditë i shohim në televizor dhe askujt nuk po i shkon fytyra!”.

Çfarë përgjigje, them me vete. Replikë se jo mahi...

SYTË E ÇDOKUJT NUK SHOHIN MIRË!

Pas të gjitha këtyre tollovive psikike, viti i sivjetmë më shumë po shkon me greva sesa me punë.

“Viti i sivjetmë po shkon keq”, më thotë gruaja.

“Keq, sepse që në fillim ia nise me qeverinë, me kryeministrin... E, po harron se Kosova sot i ka 105 njohje zyrtare. Andaj, nëse fillimi është i keq, fundi do të jetë i mirë”, i them unë.

“E, kush e pret fundin, ore?!”, ma ktheu ajo me të shpejtë.

“Gjërat e para çdo herë janë më të vështira, por pastaj mësohet njeriu me to.

Për shembull, grua, a të kujtohet dashuria e parë? Puthja e parë? Me siguri, këto dy gjëra i kujton me ëndje... të është dukur sikur po ecë nëpër re...”.

“Lëri ato pallavra, alla hile! Po ku sheh gjë të mirë te ne?”, ma kthen me plot nervozë.

“Eh, duhet t’i kesh sytë e qeveritarëve, moj grua, për të parë gjëra të mira, jetë të mirë... Nuk mundet çdo kush të sheh mirë e bukur. Nuk është pranverë për çdo kënd, por vetëm për ata që dinë të dredhojnë...”, ia ktheva me tallje, sepse e pash se gjërat po thellohen.

Sokol Murturi



Vetëm budalla martohet!

Anketa për dashurinë, puthjet dhe martesën është bërë me fëmijët e njërës nga shkollat tona fillore në Prishtinë, të moshës 10-11 vjeç. Përgjigjet e tyre janë qesharake dhe të singerta...

Kur duhet të martohesh?

- Së pari duhet të gjesh dikë që i pëlqen të njëjtat gjëra si ti. Për shembull, ty të pëlqen futbollli, atëherë edhe asaj duhet t'i pëlqejë. Ty të pëlqen çipsi e edhe asaj duhet t'i pëlqejë.

Altini, 10 vjeç

- Ti vetë nuk mund të vendosësh se kur do të martohesh. Zoti vendos për atë punë. E, kur të vjen ajo kohë ti martohesh.

Fifi, 10 vjeç

Sa vjeçar duhet të martohesh?

- Më së miri është në moshën 25 vjeç, meqë ke mjaft kohë ta njohësh burrin tënd të ardhshëm.

Gresa, 11 vjeçe

- Nuk e di! Vetëm budalla martohet!

Blerdi, 10 vjeç

Ç'kanë të përbashkët prindërit tuaj?

- Që të dy nuk dëshirojnë të kenë më fëmijë. Më kanë lindur mua dhe po thonë kjo mjafton!

Edina, 10 vjeçe

Çka flasin kur një djalë dhe një vajzë janë bashkë?

- Kur një djalë dhe një vajzë janë bashkë ma merr mendja se flasin se si do të puthen kur të rriten.

Galdimja, 11 vjeçe

Çka do të bënit nëse vajza që e doni nuk u do?

- Do të rrija në shtëpi dhe nuk do të shkoja as në shkollë, sepse secili nxënës do ta kuptojë se po qaj për dashuri! Do të mbyllesha në shtëpi dhe do të shikoja filma të animuar...

Mali, 11 vjeç

Kur dikush duhet t'u puthë?

- Kur është i bukur, më i rritur se unë dhe më sjell lule...

Dorina, 10 vjeçe

- Kur dikush më puthë, atëherë edhe duhet të martohem me të dhe të bëjmë fëmijë...

Valmiri, 11 vjeç

A është mirë të martohesh?

- Jo, se kur martohesh edhe bënë fëmijë. E, unë nuk i dua fëmijët. Ata bëjnë zhurmë dhe nuk mund t'i shoh filmat në kompjuter...

Dielli, 10 vjeç

- Vajzat është mirë të mos martohen, ndërsa djemtë po se nuk dinë të gatujnë...

Hëna, 10 vjeçe

Çka duhet të bësh që martesat të jetë e mirë?

- Burri duhet t'i thotë gruas se është e bukur edhe nëse ajo duket si autobus!

Andi, 11 vjeç

Sh. H.



PRISTINE APARTMENTS



/pristine_apartments

049-767-977 viber/whatsapp
Viber/Whatsapp +49 176 58080551



Shkencë. Etikë. Art.

FYTYRA & QAFA

- Operimi i Hundës (Rhinoplasty)
- Operimi i Qepallës
- Operimi i Veshit (Otoplasty)
- Ngritja e Vetullave
- Ngritja e Qafës
- Korigjimi i buzës së çarë, hundës dhe qiellzës së butë
- Korigjim i Nofullës
- Ngritja e Fytyrës - Facelift

GJOKSI

- Zmadhimi i Gjirit - me implante MENTOR
- Ngritja e Gjinjëve
- Zvogëlimi i Gjirit
- Zvogëlimi i Gjirit tek Meshkujt

OBESITETI

- Baloni Gastrik - Spatz[®]
- Gastric sleeve
- Dietë e personalizuar

TRUPI

- Abdominoplastika
- Liposuction
- Formimi i trupit me definim të lartë
- Ngritje Krahu (brachioplasty)
- Ngritja e kofshes
- Ngritja e mollaqit - vitheve
- Rritja e mollaqit - vitheve
- Labioplastika - vaginoplastika
- Aplikimi i expanderëve - zmadhuesve

PROCEDUARA MINORE

- Heqja e Moleve / Nishanëve
- Heqja e Tatuazheve dhe Mbresave

MBJELLJA E FLOKËVE

- Mbjellja e flokëve
- Mbjellja e mjekrës
- Mbjellja e vetullave

EKIPI NDËRKOMBËTAR NË BASHKËPUNIM ME EKIPIN VENDOR I JAPIN KUPTIM TË BUKURËS



DR. SELAHATTIN
ÖZMEN



DR. NEDŽAD
RUSTEMPAŠIĆ



DR. GUIDO
MARONATI



DR. IVO
DŽEPINA



DR. ŞÜKRÜ
YAZAR



DR. NECDET
UÇAR



DR. YUNUS
YAVUZ

BOOM

*Fustanet
asimetrik,
fiksime i yjeve
shqiptare*

*Dasmat
më të
bukura
të VIP-ave*

Liza Gjini

*maestro e fushës
së bukurisë dhe estetikës*

*Të veshur
me të zeza
në dasmën*

*e Armina Mevlanit
dhe Shkëlzen Berishës*

Fustanet asimetrik, fiksimit i yjeve shqiptare

Veshjet asimetrike duket se janë të preferuarat e yjeve të shoubiz-it shqiptar, artisteve dhe moderatoreve bukuroshe.

Kemi parë një sërë yjesh shqiptare që e preferojnë këtë veshje, në modele dhe ngjyra të ndryshme...

BEATRIKS

Një tjetër ish-banore e "BBV", Beatriks Ramosaj, ka preferuar këtë veshje, teksa kohë më parë ka pasur një veshje asimetrike me ngjyrë të zezë.



NEVINA

Gjithashtu, Nevina Shtylla, shumë e vlerësuar për shijen e saj në veshje, ka pasur një fustan asimetrik, duke kombinuar ngjyrën e verdhë në të.



BENIADA

Beniada Nishani ka pasur një veshje të tillë me ngjyrë të zezë, në një nga primet e "Big Brother Vip Albania" dhe, pa dyshim, ka shkëlqyer.



BORA

Bukuroshja Bora Zemani, një tjetër yll që ka pasur fustan asimetrik. Me ngjyrë rozë të nderur, shoqëruar me doreza, Bora ka shkëlqyer me këtë look.



FJORALBA

Mikja e saj, Fjoralba Ponari, ka pasur një veshje asimetrike, gjithashtu. Këtë herë me ngjyrë portokalli, vërtet të veçantë.



ARBANA

Prezantuesja dhe moderatorja shumë e dashur për publikun shqiptar, Arbana Osmani, ka pasur një fustan të zi asimetrik me një krah, pikërisht në festën e "BBV".

ANTONELA

Antonela Berisha ka zgjedhur një veshje asimetrike, po ashtu. Antonelën e kemi parë me fustan të bardhë me një krah.



MARINA

As Marina Vjollca nuk i ka rezistuar këtij trendi, teksa e kemi parë me fustan asimetrik gjatë shtatzënisë.



ADROLA

E fundit në këtë listë, por me një zgjedhje për t'u admiruar, pa dyshim, Adrola Dushi, e kemi parë me fustan të bardhë të gjatë. Asimetria qëndronte, pikërisht, në pjesën e sipërme, meqë fustani ishte me një krah.

Dasmat më të bukura të VIP-ave

Priscilla Ann Beaulieu dhe Elvis Presley



Marilyn Monroe dhe Joe DiMaggio



Bianca Pérez Morena de Macias dhe Mick Jagger



Kate Moss dhe Jamie Hince



Gisèle Bündchen dhe Tom Brady



Keira Knightley dhe James Righton



Yoko Ono dhe John Lennon



Amal Alamuddin dhe George Clooney



Mick Jagger dhe Bianca organizuan dasmën e tyre në St. Tropez.

John Lennon dhe Yoko Ono zgjedhën të ishin sportivë, por veshur me të bardha.

Marilyn Manson dhe Dita Von Teese preferuan ngjyrën vjollcë për fustanin e nuses Vivienne Westwood etj.

Këto janë disa prej personazheve të famshëm, të cilët kanë zgjedhur detaje të tjera, përtej kishave dhe fustanit të bardhë për ditën më të veçantë të jetës së tyre.

Edhe pse sot disa prej këtyre çifteve janë ndarë, dasmat e tyre do të mbahen gjatë në mend...

“Boom”

Të veshur me të zeza në dasmën e Armina Mevlanit dhe Shkëlzen Berishës

Blogerja, Armina Mevlani, e kurrorëzoi dashurinë e saj me martesë me Shkëlzen Berishën, djalin e ish-kryeministrit Sali Berisha.


Të shumta ishin postimet e VIP-ave të ftuar në dasmë, ku duket se është zbuluar dhe kodi i veshjes. Siç është parë nga pamjet e publikuara, kryesisht VIP-at, kishin zgjedhur të vishen me ngjyrë të zezë, ngjyrë që tregon mjaft mirë elegancën.

Personazhet e njohura femra ishin veshur me fustan të zi, duke u shfaqur të guximshme dhe mjaft elegante.

OLTA GIXHARI, AGNESA VUTHAJ, VALDRIN SAHITI NË TË ZEZA

Mes personazheve ishte Rudina Hajdari, Olta Gixhari, Agnesa Vuthaj, Dalina Buzi, Amarda Toska, Erla Mëhilli, Floriana Garo, Albana Vokshi, Valdrin Sahiti dhe shumë të tjerë, që si zgjedhje të tyre në këtë festë gëzimi kishin zgjedhur të zezën.

N.





Liza Gjini është profesionale e dëshmuar në fushën e bukurisë dhe estetikës, zonjë e cila ka investuar shumë në vete që të jetë kjo që është sot, maestro në profesionin e saj.

Grua e fortë dhe e pandalshme në rrugën e suksesit, një ëndërrimtare e kahershme, e cila ka ditur që ëndrrat e saj t'i bëjë realitet. Me më të mirën e zanatit, pronaren e Qendrës së famshme të bukurisë "Teuta Beauty Center" në Gjakovë, flasim në "Boom"...

Liza Gjini, maestro e fushës së bukurisë dhe estetikës

Si e përshkruan veten?

- Jam Liza Gjini, nga Gjakova, frizere. Këtë profesion e praktikoj qe një kohë të gjatë. Gjithashtu, konsideroj se jam grua dhe nënë e fortë dhe e guximshme.

Kur nise të merresh me këtë profesion?

- Me këtë profesion jam marrë që në moshë shumë të re. Por, vetëm pas një periudhe të gjatë arrita ta hapë sallonin tim. Në total i kam 20 vjet përvojë pune në këtë zanat, të cilin ditë pas dite e kam perfeksionuar edhe më shumë. E dua punën time dhe merrem rregullisht me të.

A ishte ky profesion ëndrra jote e kahershme?

- Po, prej periudhës së adoleshencës e kam kuptuar se çfarë dua dhe cila është ëndrra ime për jetë.

Kjo është ëndërr imja, e cila prej vitesh është bërë realitet. Nuk do të ndalem kurrë së jetuari këtë ëndërr.

Cilat janë shërbimet që ofroni në sallonin tuaj të bukurisë?

- Ofrojmë shërbime të ndryshme, duke nisur nga shkurtimi i flokëve, fenerimi, ngjyrosja, shatiret ose ombret, grimë, ngjitja e flokëve, frizurat, mbjellja e thonjve, tretmani me fije kolagjeni, pastrimet e fytyrës, realizimi i vetullave microblading etj.

Cili është shërbimi që e bën gjithmonë me shumë qejf?

- Shërbimet të cilat i bëj me shumë qejf janë vetullat, ngjitja e flokëve dhe tretmani me fije kolagjeni. Gjithsesi, jam gjithmonë e gatshme për vetulla microblading.

Gjithashtu, aftësoni profesionalisht vajza e gra. A mund të na thoni se në çfarë drejtimesh ofrohen kurset?

- Kurset i ofrojmë për profesionin e frizeres dhe tretmanit të kolagenit.

Çfarë ndjenje është t'i zbukurosh të tjerat?

- Është ndjenjë e veçantë dhe e mirë kur një grua apo vajzë të beson ty që ta bësh të bukur e të ndihet e lumtur, sidomos në

ditët e saj më speciale. Dhe, kjo ndjenjë është e papërshkrueshme.

Njiheni si mjeshtrë e madhe e këtij profesioni. A u është dashur shumë kohë të bëheni kjo që jeni sot?

- Normalisht, të arrij deri këtu më është dashur t'i kaloj disa sfida. Por, falë familjes sime, e cila gjithmonë më ka mbështetur, ia kam dalë me sukses dhe jam këtu ku jam sot...

Mes klientësh, a keni edhe emra të njohur?

- Po, kemi pasur edhe emra të njohur të estradës, por te ne të gjitha klientet i trajtojmë njëjtë dhe pa dallim.

Kë nga të njohurat tona do ta transformoni?

- Do të doja ta transformoja Leonora Jakupin.

A mendoni se duken bukur këngëtarët tona?

- Secila është e bukur dhe e veçantë në mënyrën e vet...

Çka u ka ndihmuar më së shumti në jetë, por edhe në punë?

- Në jetë më ka ndihmuar më së shumti mbështetja e familjes. I falënderoj, sepse gjithmonë më kanë përkrahur.

Gjithashtu, në punë më kanë ndihmuar dy vajzat e mija dhe gjithçka është bërë më e lehtë me to. Vajza e madhe, Teuta, merret me pjesën e grimit, ndërsa e vogla, Diana, me pjesën e thonjve.

A jeni e plotësuar?

- Natyrisht, ndihem e plotësuar, gjithmonë duke e shikuar suksesin që kam arritur dhe ëndrrat që më janë plotësuar.

Cila është jeta juaj përtej profesionit?

- Jeta ime jashtë profesionit është e thjeshtë. Jashtë orarit të punës mundohem të jem sa më pranë familjes dhe ta shijoj kohën me ta.

Një porosi për femrat?

- Dojeni veten, sepse secila jeni e veçantë në mënyrën tuaj!

Nderim Neziri



Dalin fotot e Loredanës nga spitali

Për çdo çift, dita më e lumtur mendohet të jetë ajo e ardhjes në jetë të një fëmije. Kështu ishte edhe për ish- çiftin Loredana Zefi dhe Mozzik, të cilët pak vite më parë u bënë prindër të një vajze.

Në foto shihen Loredana, Mozzik dhe vajza e tyre e porsalindur, Hana, së cilës reperi i ka dedikuar këngë, së fundi.

Ata duken më se të lumtur. Por, siç dihet, ditët me diell për lidhjen e dyshes në fjalë ka kohë që kanë përfunduar.



Së shpejti dasmë në familjen e Shkurte Fejzës



Djali i vetëm i këngëtares Shkurte Fejza, Arbër Behluli, kujdeset të qëndrojë larg vëmendjes medietike.

Ndonëse disa herë është bërë pjesë e medias rozë, ai asnjëherë nuk ka dhënë material për të qenë emër i lakuar.

Siç mësojmë, Arbëri, i cili prej vitesh është fejuar, së shpejti do ta kurorëzojë dashurinë e tij me martesë. Përgatitjet për dasmën e madhe tashmë kanë filluar në familjen e këngëtares Shkurte Fejza.



Nora Istrefi ende bomba e estradës

Nora Istrefi është këngëtarja e hiteve, që, së fundi, ka ardhur me këngën me titull "Ciao".

Ylli i muzikës është shfaqur në formë të shkëlqyer në të gjitha skenat e videoklipit të ri, ku ka vazhduar t'i ekspozojë

linjat ideale.

Këngëtarja, që jeton vetëm, nënë e një vajze, si gjithmonë merr vëmendje për paraqitjet e saj.

Nora jeton në Prishtinë. Dhe, më në fund, kanë pushuar thashethemet rreth jetës së saj private...




allure[®]
BEAUTY



Plexr[®]
Made in Italy

Allure Beauty

Sfido moshën!

*Kërkoni një foto para 10 vitesh,
Plexr si me magji ju rikthen atë ditë.*

*Krijon sipërfaqe të re të lëkurës
pa rrudha, pa shenja,
pa njolla, pa asnjë imperfeksion.*

Mjafton vetëm 1 Seancë.

Allure Beauty- Garanci Profesionale!

Kujdes nga imitimet!

Në orën 3 pas mesnate dridhet toka!

Teksa po flisnim unë dhe ime grua se si është mirë të kemi kujdes se mund të ndaheshim shkaku i një mosmarrëveshjeje të vogël që patëm ditë më parë lidhur me një ëndërr që kisha parë se si gruaja më tradhtonte, më luti të pinim çaj rusi. Pas çajit më tha se do t'ma përgatis edhe drekën, por u bëra xhentëlmen dhe i thashë se do të drekojmë në restorant!

Dhe, pas drekës së shijshme në restorant, i thashë gruas: "E mirë paska qenë ëndrra, për besë. Nuk kisha menduar ndonjëherë se mund të del kaq e ëmbël". "Epo, është mirë kur m'i tregon ëndrrat, sepse përfitojmë të dy", më tha ajo. Më qeshet me të madhe dhe i premttoj se tani e tutje kam për t'ia treguar të gjitha ëndrrat, pos ndonjëres që mund të jetë pa lidhje, ashtu siç i thoshte babai nënës sime se edhe ëndrrat i kishte pa lidhje. "Jo, edhe ato pa lidhje kanë njëfarë lidhje", thotë ajo. "Pajtohem, grua, do t'i tregoj të gjitha", i premttoj unë, duke mbajtur rezervën se do ëndrra s'mund t'ia tregoj kurrë. "Eh, mirë, a do m'i tregosh edhe ti mua të gjitha ëndrrat?", i them në vazhdim. "Po, patjetër, çka do që shoh ëndërr do të tregoj", më tha ajo. "Mirë, pra, me kënd ke parë ëndërr se je larë në Sarandë?", i them unë. "Marrëveshja për ëndrrat vlen prej sot

e tutje", foli shpejt e shpejt, sepse di të dredhojë ajo. Dhe, fjalë pas fjale, gati i acaruum punët përsëri. "A e sheh se edhe ti mban të fshehta prej meje!", i thashë me zë të ashpër. Dhe, bimë në shtrat të egërsuar, shpinë për shpine, bile ajo e tërhoqi pak shpinën që të mos prekej me timen, sepse prekja kushedi se çka sjell natën.

GRUAJA MA KTHEN SHPINËN NË SHTRAT!

Kah ora 3 pas mesnate, i pagjumë, ngrihem të pi ujë dhe kur kthehem të bij në shtrat nis t'më silltet dhoma. "Ndoshta po dridhet toka...", i them gruas. Dhe, nga frika ngrihet shpejt. "Nuk po dridhet toka, por koka jote, o njeri!", ma ktheu ajo. Por, mua më silllej dhoma sa andej e sa këndej dhe i them se unë po vdes grua. Ajo shpejt një gotë ujë ma hedh

në fytyrë. Nis të qajë dhe ma lag edhe qafën.

"Më doli ëndrra", them me vete. Ajo më thotë se më ka rënë shtypja e gjakut, prandaj edhe më silltet dhoma. "Ka mundësi, grua, por këtë s'e kam përjetuar më parë, e ndoshta tani e tutje mësohem", i them unë. "Mos të lashtë Zoti pa grua!", kanë thënë të vjetrit. A po e sheh se e paskan pasur mirë kur kanë thënë kështu. Çka do të kishe bërë sikur të mos isha unë tani?", foli me krenari ajo. "Hesht, se akoma nuk më ka kaluar! Mos bëj hop para kohe! Vetëm nëse më kalon do të kesh arsye të lavdëroresh. Ja, pra, ëndrra se ti ishe dashnore e shokut tim... Kjo qenka tepër e rëndë", i them, në fund, unë. E ajo, në vend të fjalëve: "Natën e mirë", më thotë: "Herëve të tjera mësohu të mos shohësh ëndrra, sepse hakmarrja qenka në orën 3 pas mesnate!".

S. M.



Boat Trip

Don't forget this summer!



 /canyonmatka_

TEL: +38970726265

Muaj pas muaji dhe vit pas viti ditët e rinisë sime të mallkuar po treteshin derisa unë vazhdoja të jetoja një jetë tmerrësisht të ngrysur, pothuaj tërësisht të privuar nga jeta e rëndomtë. Jeta ma diktonte një jetë të mërzitshme, aq më tepër kur frymoja në një shtëpi të çmendurish...

Shpesh dilja në qytet dhe kthehesha ashtu si isha nisur: e mërzitur, e paqejf dhe qehrerëndë. Disa nga djemtë më lëshonin fjalë të shumta rrugës, por unë as që ktheja kokën t'i shikoja. Nganjëherë më ndodhte të takoja ndonjë familjar, mirëpo as me ta nuk e zgjasja shumë, sepse preferoja vetminë deri në gjetjen e ndonjë djali që do ta e kisha për fat të jetës.

BËHESHA KINSE NUK I DOJA FISHKËLLIMAT E DJEMVE...

Më e keqja ishte se në mua dyshonin të gjithë se kisha të dashur, a, në të vërtetë, nuk kisha askënd. Kështu, duke qenë e rregullt çdo ditë në qytet, e vëreja se një tip shtatgjatë, fytyrëimët dhe i veshur me elegancë, më përcillte një copë të mirë të rrugës.

Shkova nuse në shtëpinë e të çmendurve!

Por, më duhej të isha e matur dhe të mbaja qëndrim serioz sikur kisha mbajtur vite me radhë.

Mirëpo, nga familja ime nisën kokëçarjet pse nuk isha me askënd, çka prisja, deri kur kështu, e të tjera...

Andaj, kisha arsye t'ia jepja vetes një shans. Nuk ia vlente të prisja më shumë dhe të shikoja kah qielli. Duhej të rrezikoj, në të kundërtën do më shkelte koha dhe do mbesja në shtëpinë e prindërve.

PAK NGA PAK FILLOI TË MË HYNTE NË ZEMËR

Më në fund, i thashë vetes se nuk duhej të frikësohesha më, por do provoj të rrezikoj diçka për të mirën time.

Dhe, herën e parë që e pashë pas meje, nuk durova dot më. U ulëm në një lokal të fshehtë në periferi, aty ku nuk kishte shumë zhurmë dhe hyrje-dalje pa ndërprerë. Kuptova se e kishte emrin Nit dhe jetonte në periferi të qytetit.

Për çudi, fillova t'i besoj që në fjalët e para, madje edhe atëherë kur e vëreja se nuk thoshte të vërtetën. Andaj, dalëngadalë filloi ta përvetësonte zemrën time, e që ai e vërejti menjëherë.

Por, në shtëpi e mbajta fshehur në zemër, sepse doja të takohesha edhe disa herë të tjera dhe ta njihja sa më mirë...

Dhe, pas nja një muaji bashkë, e njoftova

nënë dhe babanë, të cilët u gëzuan shumë. Ata shprehën dëshirën ta njihnin sa më parë...

E, kur e njohën, nxitova të martohesha me të pa dasmë, sepse, sipas tij, nuk ia vlente të shpenzonte para pa lidhje, e që paratë t'i shfrytëzonim në ndonjë plazh të Shqipërisë.

Por, që ditën e dytë pas martesës e pashë se ku më kishte sjell fati im i ri. Kuptova se kisha shkuar nuse në shtëpinë e të çmendurve. Motrat i kishte me sëmundje mentale dhe fillova të frikësohesha shumë. Minirja dhe Sadija ishin në shkollë fillore, por edhe ato nuk dukej se ishin bashkë tamam...

Ndërkohë, me kalimin e kohës gjithnjë e më shumë e doja Nitin, kurse emri i vërtetë i tij ishte Nimet.

Kështu, edhe po të doja të ndahesha nga ai, zemra ime nuk donte...

Mirëpo, kur bëmë një vit martesë, jeta jonë bashkëshortore filloi të rrokullisej, sepse ai u sëmurë nga e njëjta sëmundje si ata në familjen e tij. Dhe, nuk shkuan as gjashtë muaj dhe ai vdiq, duke më lënë në shtëpinë e të çmendurve...

E, pas një jave e lashë atë shtëpi dhe u ktheva sërish në shtëpinë e vajzërisë, ku jetoj edhe sot, ani pse nga ajo kohë kanë kaluar rrafsh 15 vjet.

Merita A.



Rruga Jul Variboba,
Tiranë 1010, Shqipëri



[/lasuite.boutiquehotel](https://www.instagram.com/lasuite.boutiquehotel)

Kontakti: +355 4 452 2922
Email: info@lasuite.al



Pamje e qytetit Longyearbyen

Në cilin qytet nuk lejohet vdekja?

Misteret nuk kanë fund në këtë botë. Në vendbanimin e vogël, të quajtur Longyearbyen në qendër të Svalbardit, në Norvegji, ka disa ligje shumë të veçanta që ndiqen nga 2000 banorët e tij.

Ky vendbanim njihet si qyteti më i afërt me Polin Verior, ndaj në periudhën e dimrit nata mund të zgjasë deri në 4 muaj.

Përveçse një vend i errët e i ftohtë, ky qytet i vogël nisi të tërheqë shumë turistë, jo vetëm për historinë e tij magjepsëse, por edhe për rëndësinë e tij për të ardhmen e njerëzimit.

Longyearbyen u krijua si një vendbanim për njerëzit që punonin në minierën e qymyrit, e cila në atë kohë ishte një nga minierat më të mëdha të qymyrit

në Skandinavi.

Në vitet 90 miniera u shterua, por punëtorët nuk u larguan. Dy ligje shumë ekstreme, të vendosura nga vetë njerëzit që jetojnë në Longyearbyen, janë: Nuk u lejohet njerëzve vdekja dhe nëse janë në prag të vdekjes duhet të shpërngulën në ndonjë vend në jug të Norvegjisë.

Pse? Sepse, aty nuk mund të varroset njeriu shkaku se është ftohtë dhe trupi do të dekompozohet shumë ngadalë. Kjo do i tërhiqte arinjtë polarë, që janë një nga rreziqet më të mëdha për banorët e kësaj zone.

Prandaj, në rast se dikush ndihet shumë i sëmurë deri në pikën kur mund të vdesë, ai është i detyruar të dërgohet në anën jugore të Norvegjisë.

Aktori Astrit Kabashi i hynë politikës!

Aktori i njohur, Astrit Kabashi, ditë më parë doli me një propozim për ndaljen e grevës në arsim. Ai i paraqiti dy pika, me të cilat kërkon të ndërpritet greva:

E para, arsimtarët ta pranojnë ofertën e qeverisë dhe të hapen shkollat;

E dyta, Qeveria të marrë si obligim që ligji i pagave të hyjë në fuqi më 1 janar 2023.

Dhe, të dy propozimet janë të mira e me vend.

Por, shtrohet pyetja: Pas këtyre propozimeve, mos, vallë, aktori ynë i njohur do merret me politikë?



tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

Para shtatë vjetësh, në muajin shkurt të vitit 2005, njoha një grua shumë të bukur, e që më la gojëhapur që në momentin që e pashë. Që nga ajo ditë e dija se ajo do të mbushte boshllëkun që gjithmonë ndjeja në zemrën time kur flisja për dashuri. E njoha pa prituri dhe ia shpreha pa një e pa dy dashurinë time. Dhe, kaluan dy muaj pak a shumë që ajo ta miratonte kërkesën time.

“I braktisa vajzat për femrën që dashuroja”



Ishte data 1 maj 2005 kur pranoi të dilte me mua dhe filluam një lidhje të bukur, por kishte një problem të madh, shumë të madh. Unë ende jetoja në shtëpinë time me ish-gruan dhe dy vajzat e mia. Në fillim ishte e vështirë t’ia thosha që unë ende nuk isha ndarë, por që isha i dashuruar me të. Ajo nuk pranonte të rrinte më dikë që ishte i martuar dhe më trajtonte shumë keq dhe me të drejtë. Edhe pse ajo ishte 18 vjeç dhe unë 28 (një diferencë e madhe moshe), filluam lidhjen, por ajo nuk i përgjigjej dashurisë sime. Gjithmonë më trajtonte me indiferencë. Dhe, ishte e dukshme që nuk më donte shumë.

6 MUAJ PA INTIMITET

Kaluan gjashtë muaj kështu, por kurrë nuk patëm intimitet. Derisa erdhi dita që ajo vendosi të largohej nga jeta ime. Më tha se ishte gjëja më e mirë për të dy. Unë pranova dhe u dorëzova. Vendosa kështu, sepse doja më të mirën për të dhe se unë kurrë nuk do ta bëja të lumtur totalisht. Ajo shkoi të jetonte me

prindërit në qytetin e saj. Mundesha t’i shkruaja mesazh, duke i uruar më të mirën, por ndjeja se ende e doja dhe më mungonte. Ndjeja se jeta ime nuk ishte më e njëjta pa të. Frekuentoja lagjen e saj, sepse aty afër punoja unë dhe torturohesha më shumë sa herë e shihja. Megjithatë, unë vazhdova jetën time me dy vajzat e mia dhe nënën e tyre. Pas një viti pashë një ëndërr. Pashë sikur ajo ishte shtatzënë. Pas disa ditësh shkova te shtëpia e saj dhe e pashë në derë. Vendosa të afrohesha dhe ta përshëndesja. Zemra më rrihte edhe më fortë se më parë, sepse kisha kohë që nuk e shihja. I tregova ëndrrën që kisha parë dhe më tha se gjithçka ishte në imagjinatën time dhe se nuk ishte lidhur me asnjë. Ajo u largua sërisht dhe unë nuk e shihja më aq shpesh. Pas dy muajsh të tjerë i telefonova dhe m’u thye zemra edhe njëherë kur mora vesh se ajo do të martohej dhe se ishte shtatzënë. U dorëzova, por gjithmonë i dërgoja mesazhe. Tani ajo më thotë se më do dhe se është pënduar për atë që bëri se nuk ishte i lumtur me burrin që jetonte. Të paktën, kështu më thoshte

mua. Edhe unë nuk isha i lumtur përkrah nënës së fëmijëve të mi.

SI MË BINDI T’UA KTHEJ SHPINËN VAJZAVE TË MIA?

Kaloi kohë dhe ajo erdhi të jetonte në të njëjtin vend si gjithmonë. Unë e shihja vetëm, më thoshte se më donte mua. Ajo e dinte se edhe unë nuk jetoja mirë me nënën e fëmijëve të mi. Por, ende nuk isha ndarë, sepse nuk doja që vajzat e mia të vuanin. Një ditë vendosëm të lidheshim dhe unë ndjej të njëjtën dashuri që gjithmonë kam ndjerë për të. Unë e doja shumë dhe një ditë vendosa t’i lë vajzat e mia, sepse doja të jetoja me të. Por, thellë një zë brenda meje më thoshte se atë që bëra do ta paguaj ndonjë ditë. Ika, sepse e dua dhe do ta dua gjithmonë, por jam babai i dy vajzave. Edhe pse shumë thonë se mjafton që të kujdesesh për to, unë nuk bindem. Unë mendoj se nuk bëhet fjalë për atë që mund t’u jap, por për kohën që mund të kaloj me vajzat e mia.

Burim Bajrami



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritëse që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjektiv;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulllet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Nuk jam e kënaqur në martesë!

Mungesa e seksit në martesë duket se është një episod që përjetohet më keq nga gratë sesa nga burrat, sidomos kur ata që e refuzojnë raportin intim janë këta të fundit.

“Jam qe dhjetë vjet në martesë dhe, marrë në përgjithësi, të gjithë që më njohin mendojnë se kam një martesë të mirë.

Mirëpo, nuk është bash kështu”, shprehet Nora, nga Fushë-Kosova, në pyetjen që ia bëjmë se si i shkon jeta në martesë.

Nora, 32-veçje, pohon se kur ajo dhe burri i saj u takuan 15 vjet më parë, ata bënë seks çdo kohë që ata mundeshin. Por, pas pesë vjetësh martesë, jeta e tyre seksuale filloi të tkurrej, nga shumë herë në javë, në një herë muaj!

Ajo nuk është e lumtur me këtë gjë, por burri i saj nuk është i interesuar për seks dhe nuk dëshiron të flasë sesi mund ta përmirësojnë këtë gjë që ajo e sheh si një problem të madh.

“Kam marrë një mori ankesash nga ai.

Ai nuk është i disponuar, sepse puna në lokalën e tij tregtar nuk po i shkon si duhet, se gjithmonë vjen në shtëpi i lodhur, se ka dhembje lukthi a gjetiu...”, thotë ajo, e zhgënjyer me jetën e saj seksuale.

Ajo dyshon se burri i saj, nëse nuk ka femër tjetër, ka humbur dëshirën për seks, por ai ka refuzuar të vizitohet te mjeku, me qëllim të tejkalimit të këtij problemi bashkëshortor.

Kur ajo flet për mungesën e seksit në raportin e tyre, burri i saj ose mbyllet ose merr pozicion mbrojtës. Ajo i qahet atij se kështu ajo ndihet e shëmtuar dhe se ata janë kthyer në shok-dhomë.

Gratë, ndoshta, nuk mund të varen nga

burrat për të qenë nxitëset seksuale në marrëdhënie, por kjo nuk do të thotë se ato janë imune në refuzimin e seksit, sidomos me normat tona tradicionale gjinore ende me ndikim. Burrat ndjehen të poshtëruar kur ata nuk mund të kryejnë seks, edhe nëse kjo është një pengesë psikologjike apo çështje fiziologjike.

Shkaqet e zakonshme fiziologjike që çojnë në rënieën e dëshirës seksuale të burrave përfshijnë mosfunksionim të ereksionit, si përdorimi i medikamenteve (ilaçet kundër depresionit) dhe testosteroni i ulët ose problemet e marrëdhënieve në çift, thonë psikologët.

Diturie Haxhaj



ANABELA
FLOWERS



TEL: +355698663395

Marrim porosi edhe nga jashtë Shqipërie

 /anabela_flowers



Jeta merr kuptim me më të dashurit tuaj.

Lagjja Panorama – Ferizaj

C
CIMA
Construction

f i g www.cimaks.com

MË SHUMË SE NJË SHTËPI BUZË DETIT

INVESTO ME ZGJUARSI



SAN PIETRO HOTEL & RESIDENCES

San Pietro
HOTELS INTERNATIONAL

BRANDED RESIDENCES

"Premium Zone", modeli i parë që implementohet në një Resort i përbërë nga Vila dhe Apartamente buzë detit. Një mundësi fantastike për të përfutur të ardhura nëpërmjet programit të qira-dhënies, në bashkëpunim me partnerin tonë strategjik "MELIA" Hotel.



PREMIUM ZONE BY MELIA

E dizenuar për të qenë luksoze dhe unike, "Premium Zone" by MELIA ofron mundësi të ndryshme Vilash dhe Apartamentesh me një pamje fantastike të detit "Adriatik", pishinë individuale dhe hapësira të gjelbëruara.

- Histori Suksesi në Investim
- Program qiradhënie
- Kthim i Investimit deri në 6% në vit
- Financim deri në 80% të vlerës
- 2400m² SPA & Wellnes
- 9 Pishina
- Zonë relaksi
- Qendër argëtimi për fëmijë
- 7 Restorante të kuzhinave të ndryshme
- Shopping Center
- Klinikë Mjekësore
- Kinema
- Fusha Tenisi
- Plazh Privat
- Casino



Gjiri i Lalzit, Durrës

+355 694017175

sanpietro_hotel_residences

sanpietro.al

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Kush më mbrojti në aksident?

Zonjë e bekuar, të shkruaj nga shtrati. Kam pasur aksident të rëndë, ndërsa dy vetë kanë mbetur me pasoja.

Kemi qenë me shpejtësi të madhe. Unë, bashkëshorti, daja i tij dhe një fëmijë yni jemi me pak pasoja.

Kam dhënë shumë sadaka... Në familje më thanë se sadakaja më shpëtoi. A është kjo e vërtetë?

“E lënduara”

Përgjigje:

Bartja e gjërave të ndryshme është përforcim i vetëbesimit te njeriu. Vetëbesimi është një mekanizëm shpirtëror që përforcon mendjen dhe shpirtin, imunitetin dhe luhatshmërinë, me të cilat miliona njerëz në botë sot kanë probleme dhe që, po ashtu, shërohen në klinikat neurologjike për shkak të streseve, presioneve, fobieve dhe frikave të ndryshme...

E, sa i përket sadaksë, është mirë që keni dhënë. Por, miliona njerëz në botë bartin me

vete gjëra të besimit, si mbrojtje nga rreziqet aksidentale apo edhe kundër keqbërjeve e magjive dhe më së shumti bartin në Turqi e në Indonezi. Sidoqoftë, askush nuk është imun ndaj magjive, nuk është i pandjeshëm ndaj streseve dhe depresioneve, aq më shumë që sot jetojmë në shekullin që psikoanalistët e quajnë “shekulli i stresit depresiv”.

Në Turqi, para disa vitesh, ka pasur më së shumti tërmete. Dhe, në atë kohë, gjatë atij procesi sizmik, ishte rritur enorm numri i njerëzve që bartnin hajmalinë. Sepse, sipas tyre, hajmalitë u kanë ndihmuar të mos kishin dëmtime të objekteve të banimit. Andaj, ka besëtytni se ata që kanë pasur me vete hajmali kanë kaluar më lehtë edhe në aksidentet e ndryshme...

Në Teksas ekziston një objekt mbrojtës që vendoset në gjoks dhe gjatë përlëshjeve që ndodhnin realisht kishte fakte se ata që e kishin bartur atë mbrojtje, në momentin e caktuar, plumbi kishte goditur pikërisht atë metal, e që i

kishte shpëtuar nga vdekja. Në rastin tuaj nuk po e përjashtoj këtë mundësi, megjithëse besimi është një fushë e gjerë, ku secila fjalë ka peshën e vet të vlerësimit. Mund të thuhet se e ka shkruar Zoti i madhërishëm që në aksident ka edhe fat dhe dikush shpëton më lehtë, si, bie fjala, ju.

Fati i vonuar

Zonjë, jam 43-vjeçare, e kam kryer fakultetin që shumë vjet. Kam punuar gjashtë vjet, por më kanë larguar nga puna për arsye se nuk bëhesha kukull e shefave. Megjithatë, kam mbetur edhe pa fatin e jetës, sepse deri para dy vjetësh e kam pritur një person, me të cilin doja ta krijoja jetën e re, por plani im dështoi.

Ti me ke pas thënë të mos e pres, por të kërkoj fatin tjetër dhe ashtu kam vepruar, mirëpo nuk kam pasur sukses.

Si të veproj tutje?

“Pa shifër”

Përgjigje:

E ke pritur dikë që ishte martuar kaheerë, prandaj ky ishte gabimi yt jetik, sepse i ke humbur 13 vjet kot për atë person.

E shkuara, megjithatë, nuk kthehet.

E, çka tash?

Nga parashikimi im del se dy oferta do t'i kesh brenda gjashtë muajve dhe e dyta do të jetë më e përshtatshme për

ty. Shpresoj shumë që do të jetë fati yt. Mos e refuzo!

A ka nusja magji?

Përsëndetje, jam zonjë, 58-vjeçare, sapo e kam martuar djalin e vetëm që e kam, por nuk jam e kënaqur me nusen.

Djali po e përkrahë dhe nuk po i bën presion që ajo të ndryshojë. Thotë se ka kohë për t'u përmirësuar...

Ajo vetëm na shikon dhe bëhet sikur do të thotë diçka, por nuk po e qelë gojën! Ne jemi të dyshimtë se ka magji...

Djali e do dhe thotë se e njeh moti dhe nuk ka qenë e tillë.

A i ka bërë kush keq qëkur ka ardhur te ne? Çka na preferon, e nderuar?

“Nëna e shqetësuar”

Përgjigje:

Nuk është puna as te magjia e as te fakti që ka pasur apo jo magji më parë. Por, nusja dëshiron të ndahet nga ju dhe të jetojë vetëm me djalin.

Këtë këshillë ajo e merr nga familja dhe kështu edhe i ka pasur premtimet nga djali juaj...

Dhe, nëse doni ta bëni të lumtur djalin, që të jetojë me të, atëherë lëreni ta jetojnë jetën si duan ata vetë...

Pra, nusja nuk ka sehire e as nuk ka pasur, por e ka qëllimin të ndahet nga ju, vjehëria.

A do t'më kthehet burri?

Përsëndetje zonja magjistare, jam grua, jetoj jashtë

Kosovës. Kam probleme me burrë. Herë pas herë është mirë dhe afër meje, por kohëve të fundit është larguar prej meje.

Kam përshtypjen se problemet tona janë brenda shtëpisë sonë, por nuk di si ta gjej formulën e vërtetë për ta pasur burrin për vete...

Të lutem, çka të bëj? Çka është në pyetje që burri po largohet prej meje?

“Era e vdekjes”

Përgjigje:

Kur jeni njoftuar me burrë e di se kush nuk të ka dashur në atë shtëpi. Keni pasur luftë të madhe derisa jeni bërë bashkë, sepse burri të ka dashur, e nëna dhe babai i tij, si dhe një motër, nuk të kanë dashur kurrë.

Por, gjërat disi kanë pushuar, në mënyrë që ka funksionuar bashkëshortësia. E, tash janë rikthyer kundër teje. Kjo do të thotë se ata janë kundërshtarët tu.

Andaj, në dhomën tënde, në rrobat tua ndodhet një plumb i shkrirë dhe disa gjëra me pak flokë. Posa t'i gjesh largoj nga shtëpia edhe gjërat kanë me u qetësuar...

A do të arrijë djali të na nxjerrë nga kriza?

Jam zonjë, jetoj në Maqedoni. Jam shpesh në depresion, nuk e di të ardhmen time. Pres nga djali të na nxjerrë nga kriza... Çka më pret në të ardh-

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

men, sepse kam mundim shpirtëror?

“Ilirida”

Përgjigje:

Shoh se je e ndarë, djalin e ke rritur vetë në familjen tënde, por është nëpërkëmbur nga familja jote!

Ai do ketë famë dhe do të krijojë pasuri të madhe, por nuk do ta harrojë sjelljen e keqe të familjes tënde.

Shoh se pas pesë vjetësh do të jetosh në Zvicër.

Jam më e vjetër, por e dua...

Jam një grua që jetoj jashtë Kosovës. Kam ardhur në pushim, por jam shumë e brengosur për personin me të cilin duhemi, sepse jam më e vjetër se ai dhjetë vjet. E dua përjetësisht, por nuk di a do ta kem fat...

“Fr”

Përgjigje:

Ti je e ndarë nga burri, je nënë dhe e do dikë që është i huaji! Lidhjen tënde e dinë shumica atje, por nuk mund të zgjat shumë...

Fëmijët tu janë të rritur dhe nuk do ta durojnë gjatë të dashurin tënd.

Andaj, ktheju fëmijëve plotësisht dhe mos humb kohë pas tij!



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE



SHERWOOD

Resorts and Hotels



**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA